



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 30 mars 2017, në mbledhjen e XXXVIII - të (tridhjetetë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Ejup Visoka, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Fatmir Gashi, drejtor i Drejtorisë së Administratës, Mrika Thaçi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Florije Besholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Inspeksionit, Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Muharrem Haziri, OSBE.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, njoftoi se Ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së kaluar nuk është dërguar me thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhjeje për shkak se Zyra ligjore ka qenë e zënë në përgatitjen e propozimit të Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha komunale, mirëpo një ditë pa e dërguar thirrjen për këtë mbledhje ka arritur një shkresë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, sipas së cilës të gjitha komunat janë të obliguara të harmonizojnë Rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoha komunale me Ligjin për kundërvajtje, andaj kjo është arsyeja që propozimi i Rregullores së cekur nuk është përfshirë në rend ditë për këtë mbledhje.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, kërkesë në këtë Komitet por edhe në Kuvend ka qenë që Komandanti i Stacionit të policisë në Podujevë, të raportoi për gjendjen e sigurisë në Komunë, lidhur me këtë unë kam biseduar ma Komandantin dhe ai ka shprehur gatishmëri që në Kuvend të paraqet raportin e kërkuar, andaj kjo çështje është përfshirë në rendin e propozuar të ditës.

Kjo pikë e rendit të ditës është propozuar edhe për mbledhje të këtij Komiteti, por bazuar se komandanti nuk është i pranishëm, propozoj që kjo çështje të shqyrtohet në mbledhje të nesërme të Kuvendit.

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri së bashku me propozimin e kryesuesit.

2. Informatë e Komandantit të Stacionit të Policisë në Podujevë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Podujevës

Nuk u debatua, me konstatim që të kalohet për shqyrtim në Kuvend.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, ju falënderoj për punën dhe angazhimin e deritashëm në veçanti për respektin e ndërsjellë pavarësisht përkatësisë partiake, mirëpo në mbledhjen e fundit të Kuvendit diskutimet më tepër kanë qenë në aspektin e fushatës, andaj ju kisha lutur gjatë punës së Kuvendit të përqendrohemi në temat e rendit të ditës e pas mbledhjeve është çështje e çdo këshilltari në çfarë drejtimi e orienton aktivitetin e tij. Këtë e them ngase ndaj çdo reagimi po pason kundër reagimi e kjo shkakton vështirësi në menaxhimin e mbledhjes.

Gjithashtu në një shkrim të mjeteve të informimit ka dalë që në lëmin e arsimit 59 persona janë me shkollë fillore, në pasi e shfletova materialin përkatës konstatova se fjala ishte për 59 të punësuar me shkollë fillore e këtu përfshihet stafi teknik, kurirët dhe pastruesit.

3. Raporti Financiar për vitin 2016

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalju, theksoi, drejtori z. Isuf Latifi, në pika të shkurtra e sqaroi përmbajtjen e raportit, mirëpo vlen të theksohet se është krijuar një praktikë e mirë që raportet financiare janë duke u shqyrtuar në periudhat të caktuara sipas dispozitave ligjore.

Bazuar se ky Raport do të shqyrtohet edhe në mbledhjen e nesërme të Kuvendit konsideroj se nuk është e nevojshme që të diskutohet në detaje edhe në këtë mbledhje.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, meqë nuk kemi vërejtje në parim, pajtohem me parafolësin që debatin për këtë çështje ta lëmë për mbledhje të Kuvendit.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

4. Propozimi i vendimit për mbështetje financiare Këshillin e Veprimit Rinor Lokal në Podujevë

z. Mrika Thaçi, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalju, theksoi, në Grupi i këshilltarëve i LDK – së e mbështesim propozimin e këtij vendimi duke u bazuar në mundësit aktuale buxhetore por jemi të mendimit se në të ardhmen për KVRL do të parashihet buxhet më i madh ngase mbështetja e këtij Këshilli është edhe obligim ligjor.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, jeni në dijeni se Komiteti për Politikë dhe Financa në bazë të Rregullores për ndarjen e subvencioneve ka të drejtë që të vendos për mjete nga subvencionet deri në shumën 5.000 €, mirëpo në konsultim me Zyrën Ligjore ky

propozim i Vendimit është paraparë për shqyrtim edhe në Kuvend, vendim i cili do t'i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, pajtohem me propozimin e kryesuesit që ky propozim i Vendimit të shqyrtohet edhe në Kuvend dhe shtoi, nuk jam në dijeni për koston e aktiviteteve të KVRL – së, mirëpo konsideroj se shumica e kërkuar nuk është e madhe dhe duhet të mbështetet.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

5. Propozimi i vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, paluajtshmërinë dhe objektin hotelier në fshatin Orllan.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, drejtorët z. Abaz Llugaliu, Avni Fetahu dhe Faik Muçiqi janë në një seminar zyrtar në Shqipëri, ata kanë kërkuar falje për mungesë në këtë mbledhje por nëse ndonjë anëtar i këtij Komiteti kërkon sqarime eventuale, atëherë ndonjë prej drejtorëve të pranishëm mund të jep përgjigje.

Përndryshe fjala është për objektin hotelier “ Mileniumi “ në Orllan dhe përmes këtij propozimi të Vendimit kërkohet që të fillohet procedura për dhënien e këtij objekti në shfrytëzim për 15 vite.

Sa jam i informuar ndaj shfrytëzuesit të deritashëm është iniciuar procedura në gjykatë.

z. Fidan Rekalju, theksoi, konsideroj se nuk është e nevojshme të diskutohet por t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim i cili është kompetent për vendosje.

z. Kadi Avdiu, jam i interesuar të di se shfrytëzuesi i deritashëm a ka obligime financiare ndaj Komunës.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, shfrytëzuesi i deritashëm i atij objekti aktualisht nuk ka kontratë për shfrytëzim, ka obligime financiare ndaj Komunës dhe për këtë është iniciuar procedura gjyqësore.

Pas votimit u konstatua se kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

6. Propozimi i vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim fatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës, për vendosjen e panove reklamuese - billboard në disa rrugë të qytetit të Podujevës

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë.

Nuk pati diskutime.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

7. Plotësimi i një vendi të lirë në Komisionin për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Kadri Avdiu, theksoi, me rastin e ngritjes së komisionit të cekur, pozita e lirë për të cilën jemi duke debatuar, është propozuar nga Ekzekutivi e që edhe tani ky propozim duhet të vij nga Ekzekutivi, mirëpo këtë vendim duhet ta miratojë Kuvendi.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim, me konstatim që emri i zyrtarit të strehimit të propozohet në mbledhje të Kuvendit.

**Mbledhja përfundoi në orën 13.30'.
Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 060/04-26077/17
Podujevë,
30 mars 2017**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**